

Emri i Lëndës : Teknologjitë e informacionit							
Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
IMC 204	B	Pranverë	3.00	0.00	0.00	3.00	5.00
Lektori		Krenar Lipo, Msc					
Asistenti							
Gjuha e kursit		Shqip					
Niveli i lëndës		Bachelor					
Përshkrimi		Teknologjia e Informacionit luan një rol të rëndësishëm në formimin dhe zhvillimin e shoqërisë moderne të ditëve të sotme.. Teknologjia e informacionit përfshin mbledhjen, ndarjen, analizimin, ruajtjen dhe transmetimin e të dhënave të të gjitha llojeve me anë të kompjuterave. Ajo përfshin shume aspekte të ndryshme si Software, Sistemet e informacionit, dhe internetin. Përdorimi i saj përfshin biznesin, edukimin, perkujdesjen shëndetësore etj. dhe shtrihet në pothuajse çdo aspekt te jetës sonë. Njohuri të mira të teknologjisë së informacionit rrit produktivitetin dhe efíčencën, ul kohën e humbur dhe fuqizon kapacitetin njerëzor.					
Objektivat		Në këtë kurs synohet të jepen njohuri mbi Teknologjitë e Informacionit, në mënyrë që studentët të fitojnë njohuritë dhe kompetencat e nevojshme në përdorimin e TIK. Lënda shpjegon në sesi procesi i punës së tyre bëhet më funksional dhe efektiv me përdorimin e teknologjive të reja.					
Konceptet Kryesore		Hardware, Software, Sistemet Cloud, Rrjetet kompjuterike, Databazat, HTML, tag, rekord, fushe, Çelës primar					
Programi i Lëndës							
Java	Tema						
1	Çfarë është Teknologjia e Informacionit, Përdorimi i Teknologjisë se Informacionit si dhe benefitet e saj. Tregu per sistemet IT. Disa aspekte te IT në të ardhmen si Rritje e vazhdueshme në teknologjinë Cloud, Rritje ne IoT,Sistemet Robotike, Asistentet Dixhitale, Inteligjenca artificiale, Siguria.						
2	Pjesët përbërëse të kompjuterit, Hardware dhe Software. Perkufizimi i pjesëve si dhe lidhja e tyre me njëra tjetrën si Motherboard, CPU, RAM, buset e Sistemit, Portat I/O, Video controller, Hard Disk. Ligji Moore-it si dhe llojet e kompjuterave.						
3	Si funksionon kompjuteri. Funksionimi i një kompjuteri duke ndjekur rrymën elektrike nga kutia e shpërdarjes nëpërmjet buseve, RAM, Cache, CPU në varësi të orës së sistemit.						
4	Numrat binar dhe portat llogjike. Gjendja ON/OFF si konceptet bazë të funksionimit të sistemeve kompjuterike. Konvertimi i numrave nga sistem numërimi me bazë 10 në 2 si dhe anasjelltas. Portat llogjike AND, OR, NAND, NOR si dhe ndjekja e Outputit nga nje varg portash llogjike.						
5	Interneti dhe rrjetet kompjuterike. Historia e rrjetave kompjuterike , LAN dhe funksionimi i Tij, Cfare eshte interneti dhe si funksionon ai, Sherbimi i informacionit, Server dhe browser modeli Klient-Server si shkëmbehet informacioni në internet.DNS , URL dhe Adresa – IP.						
6	Çfarë është HTML, si bëhet markimi i tekstit, taget hapëse dhe mbyllëse. Struktura bazë e ndërtimit të një faqe webi (<head>, <body>). Ndarja e elementeve kryesorë si h1, p, div etj. Ruajtja ne tekst editor si dhe hapja faqeve te webit në browser.						
7	Ndërtimi i një faqe webi, duke dizenuar tekstin me taget e fontit, permasat e fontit, ngjyrat. Centrimi i tekstit në faqen e webit, insertimi i imazheve, me përmasa të ndryshme. Formatimi i faqes me fontet dhe ngjyrat e përshtatshme.						
8	Provimi Gjysmëfinal						

9	Databazat, përkufizimi dhe përdorimi në ditët e sotme. Konceptet bazë të një databaze si çelësi primar, fushat, rekordet, tipet e të dhënave, databazat relacionale etj. Ndërtimi i një databaze të sheshtë me elementët e saj përkatës.
10	Sistemet Cloud. Përkufizimi i sistemeve Cloud, si dhe përdorimi i tyre. Modelet e sistemeve Cloud, IAAS (Infrastructure As A Service), PAAS (Platform As A Service), SAAS (Software As A Service). Avantazhet dhe disavantazhet e përdorimit të sistemeve Cloud.
11	Fazat e zhvillimit të një Software-i. Çfarë është cikli i zhvillimit të një Software. Sistemet e-commerce, aplikacionet Enterprise, si dhe procesi i publikimit të një Software.
12	Siguria në Kompjutera , rreziqet e Sigurisë Kompjuterike. E ardhmja në Teknologjinë e Informacionit.
13	Punim Projekti, Faqe webi në HTML, duke përdorur disa paragrafe, me formatim teksti si dhe imazhesh.
14	Dorezim projekti
15	Përsëritje të temave, parapregatitje për provim.
16	Provim Final
Parakushtet	
Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.	
Literatura	
• Fundamentals of Information Technology Authors Shambhavi Roy Clinton Daniel, University of South Florida	
Referenca të tjera	
• https://digitalcommons.usf.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=1018&context=dit_tb_eng	
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat	
1	Studentët në përfundim të kursit do të arrijnë të njohin konceptet bazë të Teknologjisë së Informacionit. Ato do të jenë të aftë të njohin pjesët përbërëse të kompjuterit, të njohin komponentët e rrjeteve kompjuterike, të përkufizojnë një databazë si dhe të ndërtojnë një database të sheshtë më të gjitha elementët përkatës, të konvertojnë numra me system numërimi me bazë 10 dhe 2, të njohin portat llogjike si dhe të ndjekin llogjikën e daljes së tyre. Të kuptojnë teknologjinë Cloud dhe përdorimin e Tij, të dinë strukturën bazë të një faqe webi, si dhe të kuptojnë konceptin e markimit të një faqe webi. Gjithashtu studentët do të jenë të aftë të përkufizojnë ciklin e Zhvillimit të një Software.

Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja	
Gjysmë finale	1	25	
Kuize	0	0	
Projekte	1	20	
Projekte semestrale	0	0	
Punë laborator	1	5	
Pjesëmarrja në mësim	1	10	
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final			60
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final			40
Total			100
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	3	48
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	3	42
Detyra	1	20	20
Gjysmë finale	1	20	20
Provimi final	1	2	2
Të tjera	0	0	0
Ngarkesa totale e orëve			132
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			5.28
ECTS			5.00